



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

Nr. 1396 Prot.

Kuçovë, më 30 03 .2026

VENDIM

Nr. 25 Datë 31 03/2026

“PËR NJË NDRYSHIM PËR

MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS PËR BASHKINË KUÇOVË”

Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore në përputhje dhe në zbatim të kushtetutës, ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", si dhe të ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 Për Ratifikimin e "Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore", Urdhrit të Brendshëm nr. 211, datë 10.09.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Këshilli Bashkiak Kuçovë

VENDOSI:

1. Miratimin e Programit të Transparencës të Bashkisë Kuçovë sipas Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Për zbatimin e përditshëm të Programit të Transparencës është përgjegjës Kryetari i Bashkisë. Në ushtrim të kësaj përgjegjësie, Kryetari i Bashkisë me urdhër nr. 121, datë 12.05.2020 ka caktuar z. Erion Daci, Koordinator për të drejtën e informimit si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Me urdhër nr. 19, datë 31.01.2019 ka caktuar znj. Lorena Sallo, Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e saj, si edhe grupi përgjegjës i ngritur me Urdhër Nr.127, datë 12.05.2020.
3. Monitorimin dhe mbikëqyrjen nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë mbi informimin e publikut nga ana e administratës së bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë duke analizuar dhe vlerësuar shkallën e zbatimit të rregullave që Këshilli Bashkiak ka vendosur, me miratimin e Programit të Transparencës. Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës do të bëhet jo më pak se njëherë në vit nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë.
4. Rishikimi dhe përditësimi i plotë, i Programit të Transparencës do të bëhet njëherë në 3 vjet. Rishikimi i Programit të Transparencës bëhet sipas të njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij. Programi i nënshtrohet përditësimit rregullisht .